



Kanton Zürich
Justizvollzug und Wiedereingliederung
Lernprogramme

Lernprogramm

PoG in

Albanisch /

Shqip

Partneritet pa Dhunë
«PoG»

Programi Mësimor (Lernprogramm) «PoG» u drejtohet burrave dhe grave, që kanë ushtruar dhunë psikologjike dhe/ose fizike në mjedisin e tyre familjar

Zbatohet që nga viti 2000 nga Justizvollzug und Wieder-
eingliederung des Kantons Zürich [Shërbimet e Ekzekutimit
Juridik dhe të Riintegritit të Kantonit Zürich] dhe

- synon të reduktojë rrezikun e përsëritjes për një vepër penale në familje
- zhvillohet në seanca individuale dhe në prani të një përkthyesje/përkthyesi
- përbëhet nga rreth 20-40 orë trajnim
- përfshin 3 seanca shtesë individuale pas fazës së trajnimit

Përfitimi juaj personal

Për të reduktuar rrezikun tuaj të përsëritjes së një vepre penale në familje, Programi Mësimor „PoG“ ju mbështet, për shembull, që:

- të analizoni arsyet e sjelljes suaj në situatat problematike të marrëdhënieve dhe të kuptoni më mirë motivet pas tyre
- të vlerësoni realisht rrezikun tuaj personal të përsëritjes
- të përmirësoni cilësinë e marrëdhënies përmes një rishikimi vetëkritik të qëndrimeve tuaja në partneritet
- të zhvillonit strategji për të shmangur përsëritjen në të ardhmen
- të zbatoni dhe të ruani strategjitë e zhvilluara

Përmes pjesëmarrjes aktive - siç kanë treguar studimet - ju keni një shans real për të reduktuar në mënyrë efektive rrezikun e përsëritjes.

Procedura e regjistrimit/pranimit

Departamenti i Programeve Mësimore vlerëson, me porosinë e prokurorive ose të gjykatave në Kantonin Zürich, në një bisedë personale me ju, nëse pjesëmarrja juaj ka kuptim. Nëse është kështu, Departamenti i Programeve Mësimore do të rekomandojë që prokuroria ose gjykata t'ju japin urdhëresën për pjesëmarrjen në Programin Mësimor „PoG“.

Nëse bëhet e qartë që pjesëmarrja në “PoG” nuk kontribuon mjaftueshëm në reduktimin e rrezikut të përsëritjes, ose që probleme të tjera duhet të adresohen më urgjentisht, Departamenti i Programeve Mësimore do të paraqesë sugjerime të tjera ose shtesë për ndërhyrje në prokurori ose në gjykatë.

Nëse jeni caktuar nga një autoritet i ekzekutimit juridik dhe jo nga një gjykatë ose prokurori, procedura e pranimit ndjek një proces të veçantë, të cilin personi juaj i kontaktit në autoritetin e ekzekutimit juridik mund t'ju shpjegojë.

Kushtet e pjesëmarrjes

Pjesëmarrja e detyrueshme dhe aktive është si kusht për përfundimin me sukses të programit Mësimor “PoG”. Nëse nuk ndodh kështu, do të informohet prokuroria përcaktuese, gjykata ose autoriteti i ekzekutimit juridik.

Ndarja e kostos


Nëse jeni dënuar nga një prokurori ose nga një gjykatë në kantonin Zürich dhe keni marrë urdhëresë për të marrë pjesë në Programin Mësimor „PoG“, do t'ju ngarkohet një tarifë prej 500 frangash, e cila duhet të paguhet pasi të ketë përfunduar faza e trajnimit. Për arsye të rëndësishme, ky kontribut mund të reduktohet ose të hiqet. Nëse pjesëmarrja juaj është pjesë e një mase zëvendësimi ose pezullimi, nuk do t'ju ngarkohet asnjë kosto.

Nëse jeni caktuar nga një autoritet i ekzekutimit juridik, personi juaj i kontaktit në autoritetin tuaj të ekzekutimit juridik do t'ju tregojë deri në çfarë mase duhet të kontribuoni financiarisht.

Kanton Zürich
Direktion der Justiz und des Innern
Justizvollzug und Wiedereingliederung
Bewährungs- und Vollzugsdienste

Lernprogramme

Hohlstrasse 552
8048 Zürich
Telefoni 043 258 36 30
lernprogramme@ji.zh.ch
www.zh.ch/juwe-lernprogramme



Stazioni SBB **Zürich Altstetten**: Lidhje të ndryshme treni
Tram/autobus **Bahnhof Altstetten Nord**: Trami 4, Autobusi 304, 307, 308
Stacioni i autobusëve **Bahnhof Altstetten**: Autobusi 31, 78, 80, 83, 89

Nuk ka vende parkimi në dispozicion.